



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:176098
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05438779
C.nr.248/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen kontestimore të paditësve I.A. dhe S.A. nga fshati..., komuna Skenderaj, te cilët i përfaqëson sipas autorizimeve A.F. avokat ne Prishtine, Rr..., kundër të paditurave K... "E..." Sh.a., Rr... me seli ne Prishtinë, te cilin e përfaqësoi sipas autorizimit V.K., nga Prishtina, dhe K... "S..." J.S.C, Rr..., ne Prishtinë, të cilën e përfaqësoj me autorizim përfaqësuesi M.B., nga Prishtina, për kompensimin e dëmit material, dhe jomaterial, pas *përfundimit* te seancës kryesore publike me dt.15.02.2024, jep këtë.

A K T G J Y K I M

I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit I.A. nga fshati..., komuna Skenderaj, si e bazuar.

II. Detyrohet e paditura K... "E..." me seli Prishtinë, që në emër të kompensimit për aksidentin e dt.13.04.2020 i ndodhur ne Rrugën regjionale Skenderaj-Gllogoc, t'i paguaj paditësit I.A. :

Për dëmin jomaterial:

për dhimbje trupore- fizike shumen prej -----1200 €,
për frike shumen prej-----1000 €,

Në shumë të përgjithshme prej 2200 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e gjykimit 15.02.2024 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për dëmin material:

për ndihmën nga personi tjetër shumen prej-----250 €,
për ushqim të përforcuar shumen prej -----280 €,
për rehabilitimin fizikal shumën prej -----210 €,

Në shumë të përgjithshme prej 740 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e parashtrimit të padis e dt.18.06.2020, e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë në me tepër se shumat e gjykuara si në piken II si e pabazuar.

IV. Konstatohet e tërhequr pjesa e kërkesë padisë për paditësin S.A. kundër te paditurave K... "E..." dhe K... "S..." J.S.C. për demin jo material dhe material.

V. Obligohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 864 €, në afat prej 15 dite, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

VI. Obligohet paditësi që ta paguaj diferencën e taksës gjyqësore në shume prej 20 euro, pasi që janë paguar vetëm 20 euro, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit I.A. dhe S.A. nga fshati..., komuna Skenderaj, përmes të autorizuarit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.18.06.2020, kundër të paditurave K... "E..." me seli në Prishtinë dhe K... "S..." J.S.C me seli në Prishtinë, për kompensimin e demit material, dhe jomaterial që ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale në aksidentin e trafikut rrugor me dt. 13.04.2020 në rrugën rajonale Skenderaj – Glllogoc.

Për të paditurën K..."S..." nuk prezantoi askush në seancën kryesore edhe pse ka qenë e ftuar me rregulle, gjykata në kuptim të nenit 423.4, seancën kryesore e mbajti pa praninë e sajë.

I autorizuari i paditësit në seancën kryesore deklaroi se paditësi I.A. në aksidentin e trafikut që ka ndodhur me dt.13.04.2020 në rrugën rajonale Skenderaj –Glllogoc, ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale i cili nuk ka qenë shkaktar i aksidentit, pra baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese edhe nga e paditura, dhe bazuar në ekspertizën mjekësore në këtë seance e precizoi kërkesën e padisë duke kërkuar në emër të kompensimit për demin jo material shumën prej 1500 euro, për friken e përjetuar shumën prej 1500 euro, dhe për demin material për ushqim të përforcuar për 4 jave shumën prej 400 euro, për ndihmën nga personi tjetër për 21 dite shumën prej 500 euro, për shpenzimet e rehabilitimit për 14 dite shumën prej 300 euro, e në shume totale prej 4100 euro, me kamat ligjore 8% për demin jo material nga data e gjykimit ndërsa për demin material nga data e parashtrimit të padisë dt:18.06.2020 deri në pagesën definitive.

Për pjesën e kërkesë padisë për paditësin S.A. në seancën kryesore u deklarua se e tërheqim padinë për kompensimin e demit material dhe jo material kundër të paditurave K... "E..." me seli në Prishtinë dhe K... "S..." J.S.C me seli në Prishtinë.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore për hartimin e padisë shumën prej 104 euro, taksën gjyqësore në shume prej 40 euro, për ekspertizë mjekësore shumën 300 euro, për ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150 euro, për dy përfaqësime në seanca shumën prej 270 euro e në shumën e përgjithshme prej 864 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës K... "E..." në shqyrtimet gjyqësore u deklarua se baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese por e kundërshtoi lartësinë e kompensimit të precizuar nga i autorizuari i paditësit për nga lartësia e demit pasi që bazuar në ekspertizën mjekësore dhe raportet mjekësore paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore andaj shumën e kërkuara janë të larta dhe të pa bazuara, ndërsa sa i përket kamatës ligjore gjykata të vendosë në shkallen prej 8% nga dita e nxjerrjes së vendimit dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore të vendoset sipas suksesit në procedure me propozim gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta aprovoi pjesërisht si të bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës K... "S..." J.S.C në seancën përgatitore u deklarua se e kontestomi në tersi kërkesë padinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e demit jo material dhe material, pasi që bazuar në raportin policor në përshkrimin e rrjedhjes së aksidentit shkaktar i këtij aksidenti është paditësi S.A. i cili me veprimin e tij e ka shkaktuar aksidentin.

Gjykata beri administrimin e provave, raporti i aksidentit nr.2020-AR-0736 i dt.13.04.2020, raporti i rastit nr.2020AR0736, i dt: 13.04.2020, raporti mjekësore te dt.13.04.2020,lëshuar nga klinika emergjente ne Prishtine, ekspertiza e komunikacionit C.nr.248/2020 e dt:09.02.2024, ekspertiza mjekësore C.nr.248/2020 e dt:09.02.2024.

Në kuptim të nenit 8 te Ligji i Procedurës Kontestimore, pas analizimit dhe vlerësimit te gjithanshëm te deklaratave te palëve ndërgjyqëse dhe provave te nxjerra, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike.

Ne mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se aksidenti ka ndodhur me dt.13.04.2020 në rrugën rajonale Skenderaj – Gllogoc.

Në mes palëve ne procedurë baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, ndërsa kontestuese janë shumat e kërkuara për dëmshpërblim për të cilat i autorizuari i paditësit pretendon se janë te arsyeshme dhe reale, ndërsa e paditura konsideron se bazuar ne lëndimet dhe demet qe ka pësuar paditësi janë teje te larta dhe jo ne harmoni me praktiken gjyqësore.

Ekspertet gjyqësor Dr. N.D. ortoped-traumatolog dhe Dr. Sh.M. –psikiatër, ne ekspertizën e hartuar me shkrim C.nr.248/2020 te dt:09.02.2024 bazuar ne dokumentacionin mjekësorë ne shkresat e lendes dhe pas ekzaminimit te drejtpërdrejtë te paditësit I.A. kanë dhëne mendimin profesional se ne aksidentin e trafikut, ka pësuar përdredhje e unazave te qafës, ndrydhje te kafazit te kraharorit te cilat lëndime trupore janë lëndime te lehta trupore dhe ne momentin e dëmtimit dhe gjate trajtimit mjekësorë ka pësuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht te rende 10 minuta, me intensitet te rende 24 ore, me intensitet te mesëm 10 dite, me intensitet te ultë te cilat janë me te shprehura natën ne ndryshime klimatike dhe sforcime fizike, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim te aktivitetit jetësor nuk ka, frik primare e intensitetit posaçërisht te lart disa sekonda, frik sekondare e intensitetit te ulte ne kohëzgjatje prej 30 minuta, frikë sekondare e intensitetit te mesëm ne kohëzgjatje prej 3 jave, frike sekondare e intensitetit te ultë vazhdon, ndihma e personit te trete ka qene e nevojshme 21 dite, ushqimi i përforcuar i nevojshëm për 4 jave, dhe rehabilitimi fizioatrik 2 here nga 7 dite ne vitin e pare pas aksidentit.

Konstatimin dhe mendimin e eksperteve gjyqësor nga lëmia e mjekësisë palët ndërgjyqëse në procedurë nuk e kontestuan, i cili për gjykatën u konsiderua se është i dhënë ne mënyrë profesionale dhe shkencore, prandaj i fali edhe besimin e plotë.

Me rastin e vlerësimit ne lartësinë e demit jomaterial dhe material, gjykata pati parasysh natyrën e lëndimeve trupore që ka pësuar paditësi dhe moshën e paditësit e duke u bazuar ne nenin 183 te Ligji i Marrëdhënieve te Detyrimeve te Kosovës, në të cilin është përcaktuar se për dhimbje të pësuar fizike, për dhimbjet e përjetuara shpirtërore gjykata do te gjykoj kompensim te drejte në të holla.

Me nenin 10 te Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia është përcaktuar se kompensimi i demit material dhe jomaterial behet në pajtim me dispozitat e Ligji i Marrëdhënieve te Detyrimeve.

Pjesa e kërkesëpadisë në emër të përkuqdesjes nga personi tjetër, ushqimit të përforcuar dhe rehabilitimit konsiderohet si e arsyeshme dhe gjykata me bindje të lirë e aprovoi këtë pjese të kërkesëpadisë duke u bazuar në kushtet dhe standardin jetësor në Kosovë, e në kuptim të nenit 323 të Ligji i Procedurës Kontestimore te Kosovës.

Shumat e aprovuara në emër të dëmshpërblimit për demin jomaterial dhe material janë të arsyeshme e që paraqesin një satisfakcion që paditësi me këto mjete t'i riparoj në një mase nevojat e veta materiale e që për ndryshe nuk paraqesin kompensim absolut te dëmshpërblimit.

Pjesa e kërkesëpadisë se precizuar mbi shumën e gjykuar në lartësi të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është refuzuar si e pabazuar si shume e cila tejkalon arsyeshmërin e kompensimit

Gjykata në lartësinë e aprovuar si në dispozitiv paditësit ia njohu të drejtën me kamatë ligjore të cilën e paditura duhet ta përmbushi në kuptim të neneve 382 dhe 378 të Ligji për Marrëdhënie te Detyrimeve te Kosovës.

Për tërheqjen e padisë për paditësin S.A. kundër te paditurave K... "Eurosig dhe K... "S...", gjykata ne kuptim te nenin 261.3 Ligji i Procedurës Kontestimore vendosi si ne piken IV ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore u bazua në nenin 452 te Ligji i Procedurës Kontestimore, në të cilat shpenzime janë llogaritur për hartimin e padisë shumë prej 104 euro, taksa gjyqësore për padi shuma 40 euro, për ekspertizë mjekësore shumën 300 euro, për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 150 euro, dhe për dy përfaqësime në seanca 270 euro, e në shumë të përgjithshme 864 euro.

Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të Ligji i Procedurës Kontestimore, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm,
C.nr.248/2020 me dt.15.02.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.